



SBASHK Arsimimi sot

Gusht, 2024

Gazeta elektronike

SBASHK mbajti takim me kryetarët e Sindikatave komunale të arsimit parauniversitar (SKAP) dhe kryetarin e SUSHK-ut



SBASHK mbajti takim me kryetarët e Sindikatave komunale të arsimit parauniversitar (SKAP) dhe kryetarin e SUSHK-ut. Kryetari Rrahman Jasharaj i njoftoi pjesëmarrësit e takimit me angazhimet që i ka bërë SBASHK-u që nga mbledhja e kaluar dhe pas diskutimeve që u zhvilluan, doli kërkesa që të formohet komisioni për hartimin e Draft-Kontratës Kolektive të Arsimit të Kosovës dhe brenda javës së ardhshme të përfundoj ky angazhim për ta dërguar pastaj për diskutim publik tek anëtarësia dhe pastaj të bëjë draftin ...(faqe 4)

Përfaqësues të SBASHK-ut u pritën nga kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së



Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, duke iu përgjigjur ftesës, u takua me zëvendësministrin e Arsimit, Taulant Kelmendi, me të cilin diskutoi për fillimin e vitit të ri shkollor...(faqe 6)

SBASHK takim me Qendrën Amerikane të Solidaritetit



Drejtori i Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Tiranë, z. Steven McClaud bashkë me z. Gaelan Ash, specialist i ...(faqe 5)

Flasin ata që u angazhuan rrjedhën e mbarë të pushimeve në bregdetin shqiptar



Përfaqësuesit e SBASHK-ut e kanë informuar Këshillin e Prindërve të Kosovës për gjendjen aktuale në arsim dhe për kërkesat legjitime të anëtarësisë duke shprehur shqetësimin për qasjen ...(faqe 5)

Gabim i përsëritur i MASHTI-t për tekstet shkollore



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

SBASHK-u, por edhe të tjerët, kishin kritikuar arsyeshëm vendimin e vitit të kaluar lidhur me shpërndarjen e teksteve shkollore përmes librarive dhe subvencionimin për to në xhirollogaritë e prindërve. Ky vendim ...(faqe 6)



Editorial

Na qoftë i mbarë viti i ri shkollor



Mësimdhënësit dhe nxënësit do të nisin betejën e re për dije në të gjitha institucionet arsimore e edukative të Kosovës. Ata do të flasin për pushimet dhe për detyrat që i presin gjatë gjithë këtij viti shkollor duke parë se hallet kanë mbetur të njëjta e të shumta. Disa ditë do të shkojnë me plotë sfida se kush arriti të siguroj tekstet shkollore e kush ende nuk i ka ato. Kjo nuk është mirë, sepse do të duhej që nxënësve t'u dëshirohej mirëseardhje në shkollë duke u treguar se shkolla e tyre është pajisur me mjete bashkëkohore të mësimi e ata do të gëzoheshin shumë, sepse beteja për dije do të ishte më e lehtë dhe arritjet do të ishin më të mëdha.

Nga ana tjetër mësimdhënësit në takimet e tyre të punës do të bisedojnë edhe për kushtet e punës, për ndarjen e orëve, por pjesë e bisedave do të jetë edhe paga dhe

koeficienti, i cili është shtuar nga Qeveria nga 105 në 110 e që solli një ngritje ironike prej vetëm 28 euro për të punësuarit në Arsimin Parauniversitar. Po ashtu do të flasin e do të kritikojnë Qeverinë, e cila nuk po zbaton as vendimin e Kushtetueses lidhur me vlerën e vjetëve të shërbimit. Do të bisedojnë edhe për mungesën e Ligjit për sigurime shëndetësore e për goditjet që ua bënë Qeveria duke bërë ndryshime të dëmshme të ligjeve.

Punëtorët e arsimit, edhe për kundër kësaj situatë do të vazhdojnë angazhimet në misionin e tyre të shenjtë për arsimimin dhe edukimin e brezave, por edhe do të vazhdojnë angazhimet përmes SBASHK-ut për realizimin e kërkesave të tyre e nëse dialogu mungon, atëherë mund të ketë edhe veprime sindikale. Urojmë të ketë dialog dhe SBASHK-u ishte dhe mbetet shembull i mirë për këtë.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.sbashk-rks.org

Mos hezitoni të na jepni sugjerime për përfshirjen edhe të ndonjë rubrike në interes të antarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi SOT.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbimi të antarësisë, së shpejti do të oftojmë shërbime këshilla për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në uebfaqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

Botues: **Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)** përfaqëson mbi 24.000 anëtarë në tërë territorin e Kosovës duke përfshirë edhe komunitetet, SBASHK është anëtare e Edukimit Ndërkombëtar që nga viti 1996 me drejta të plota.

Email: info@sbashk-rks.org

Tel: +383 (0) 38 226 940



Intervista

Intervistë me nënkryetaren e SBASHK-ut, znj. Vjollca Shala



Nënkryetarja Vjollca Shala, e përfaqësoi SBASHK-un në Kongresin 10-të Botëror të Edukimit në Argjentinë

SBASHK gjatë muajit korrik mori pjesë në Kongresin e 10-të Botëror të Edukimit i cili u mbajt në Buenos Aires në Argjentinë. Në këtë kongres, SBASHK u përfaqësua nga nënkryetarja, Vjollca Shala, e cila mori pjesë në mesin e mbi 1200 delegatëve nga 178 shtete të botës.

Cila ishte rëndësia e pjesëmarrjes në Kongresin e 10-të Botëror të Edukimit në Argjentinë?

Vjollca Shala: Gjatë qëndrimit gati dhjetëditor në Buenos Aires kemi takuar shumë delegacione para fillimit të Kongresit dhe gjatë kësaj ngjarje të rëndësishme për arsimin global si takime me Kryetaren e Education International (EI), me sekretarin e pergjitheshum si dhe me delegacione të Gjermanisë, Holandës, Italisë, Meksikës e shumë e shumë shteteve tjere anë e mbarë botës.

Cila ishte rëndësia e pjesëmarrjes në këtë Kongres Botëror?

Vjollca Shala: Në mes të një krize globale arsimore, mësuesit dhe personeli mbështetës arsimor janë të ndjeshëm, andaj edhe qëllimi i Kongresit të 10 Botëror të Edukimit, për qëllim kishte bashkëpunimin, krijimin e strategjive dhe identifikimin e mënyrave të mbrojtjes së mësuesit dhe për të rilindur profesionin e mësuesit. Në këtë Kongres, Presidentja e Education International (EI), Susan Hopgood theksoi rolin kryesor të EI-së në formësimin e një të ardhmeje të qëndrueshme dhe adresimin e sfidave globale përmes edukimit publik.

Si u prit SBASHK-u në këtë Kongres Botëror?

Vjollca Shala: Kongresi i 10 Botërore i Internacionales të Arsimit, i cili u mbajt nga data 25 korrik deri më 2 gusht 2024 në Buenos Aires të Argjentinës ka përmbyllur me sukses punimet duke debatuar shtruar për problemet e shumta të arsimit në të gjitha vendet e botës, e duke aprovuar një varg Rezolutash si alarm ndaj qeverive që të respektojnë demokracinë dhe të zhvillojnë dialog të sqartë në mbrojtje të figurës së mësuesit kudo në botë. Gjatë ditëve të Kongresit përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë ndjerë respektin e lartë që ka EI dhe shumë nga sindikatat e botës për Sindikatën e Arsimit të Kosovës. Kjo është thënë në takimet e zhvilluara me Presidentin e ri të EI-së Mugwena Maluleke, me zëvendës presidenten për rajonin e Evropës Johanna Jaara Astrand, por edhe me sekretarin e pergjithshëm të Internacionales Botërore të Arsimit, David Edwards, i cili mori besimin edhe për një mandat në këtë detyrë tepër të rëndësishme në EI.

Gjatë muajit

SBASHK-u mbajti takim me kryetarët e Sindikatave komunale të arsimit parauniversitar (SKAP) dhe kryetarin e SUSHK-ut



SBASHK-u mbajti takim me kryetarët e Sindikatave komunale të arsimit parauniversitar (SKAP) dhe kryetarin e SUSHK-ut. Kryetari Rrahman Jasharaj i njoftoi pjesëmarrësit e takimit me angazhimet që i ka bërë SBASHK-u që nga mbledhja e kaluar dhe pas diskutimeve që u zhvilluan, doli kërkesa që të formohet komisioni për hartimin e Draft-Kontratës Kolektive të Arsimi të Kosovës dhe brenda javës së ardhshme të përfundoj ky angazhim për ta dërguar pastaj për diskutim publik tek anëtarësia dhe pastaj të bëjë draftin final për ta dorëzuar në MASHTI.



Unanimisht u vendos që SBASHK-u të filloj iniciativë qytetare për ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti duke mbledhur mbi 10 mijë nënshkrime nga anëtarësia dhe qytetarë të tjerë për ta dërguar në Parlament për procedurat gjegjëse dhe për ndryshimet, duke kthyer pikën 6 të nentit 8 të Ligjit bazik.

Nga takimi doli kërkesa që t'i drejtohet MASHTI-t dhe Qeverisë, për ngritje të vlerës së koeficientit të pagave prej së paku 30% me rishikim të buxhetit të vitit 2024 ose me vendim të Qeverisë, por kjo ngritje të filloj së zbatuari me pagën e muajit shtator 2024.

Pjesëmarrësit në këtë takim shprehën brengosje të thellë për moszbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për Ligjin e Pagave, sidomos për pagesën e përvojës së punës në 15 vitshin e parë, por ende të paguhen me 0.25%, edhe pse Kushtetuesja ka konstatuar që kjo është shkelje kushtetuese dhe me këtë që nga hyrja në fuqi e Ligjit të Pagave, të punësuarit dëmtohen me rreth 4% të pagës. Kërkojmë nga Qeveria që këtë vendim të fillojë t'a implementojë në mënyrë retroaktive nga hyrja në fuqi e Ligjit të Pagave.

Në takim u vendos që gjatë javës së ardhshme të mbahen kuvendet e sindikatave komunale dhe universiteteve për të diskutuar me anëtarësinë lidhur me këto çështje të ngritura dhe për të marrë mendimin e anëtarësisë për llojet e veprimeve sindikale në rast të mosrealizimit të kërkesave të cekura, gjegjësisht mosfillimit të dialogut për realizimin e këtyre kërkesave. Të gjitha këto takime duhet të mbahen para mbajtjes së Këshillit Drejtues të SBASHK-ut që do të mbahet në fund të shtatorit, ku do të vendoset për hapat e mëtejshëm sindikal.



SBASHK-u takim me Qendrën Amerikane të Solidaritetit



Duke vazhduar bashkëpunimin dhe për ta dëshmuar mbështetjen e fuqishme për SBASHK-un në gjithë aktivitetet në shërbim të anëtarësisë, drejtori i Qendrës Amerikane të Solidaritetit me seli në Tiranë, z. Steven McClaud bashkë me z. Gaelan Ash, specialist i lartë për organizim në Qendrën Amerikane të Solidaritetit dhe zyrtarët e kësaj Qendre, znj. Bruna Hylviu dhe z. Brandon Muhedini, kanë vizituar SBASHK -un dhe janë takuar me kryetarin z. Rrahman Jasharaj, nënkryetaren znj. Vjollca Shala dhe koordinatorin për organizim të brendshëm, z. Ymer Ymeri.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë informuar mysafirët për gjendjen aktuale në arsim dhe për aktivitetet e planifikuara sindikale në muajt në vijim, duke u ndalur në çështje konkrete bazuar në zërin dhe kërkesat e anëtarësisë, duke u shprehur se një pjesë të këtyre aktiviteteve do t'i realizojnë në bashkëpunim me Qendrën Amerikane të Solidaritetit.



Përfaqësuesit e Qendrës Amerikane të Solidaritetit kanë përgëzuar SBASHK-un për gjithë angazhimet duke u zotuar se do të vazhdojnë me bashkëpunimin dhe mbështetjen e fuqishme për SBASHK-un në të gjitha angazhimet që do të zhvillohen në shërbim të anëtarësisë e për të vazhduar të jenë zë i fuqishëm sindikal.



Përfaqësuesit e Këshillit të prindërve të Kosovës vizituan SBASHK-un



Me qëllim që të krijohen mundësi për dialog dhe për zgjidhje të kërkesave të anëtarësisë pa pasur nevojë për veprime sindikale, përfaqësuesit e SBASHK-ut janë duke u takuar me përfaqësues të popullit në parlamentin e Kosovës dhe me palët tjera që mund të ndikojnë në realizimin e këtij angazhimi. Kështu të mërkurën e 28 gushtit, përfaqësuesit e SBASHK-ut kishin takim në ambientet e Parlamentit të Kosovës me përfaqësues të Grupit Parlamentar të LDK-së.

Po të mërkurën, kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, bashkë me nënkryetaren znj. Vjollca Shala e koordinatorin për organizim të brendshëm, z. Ymer Ymeri, janë takuar me kryetarin e Këshillit të Prindërve të Kosovës, z. Besnik Dragusha, me nënkryetarin e parë, z. Visar Islami dhe sekretarin e këtij Këshilli, z. Enver Balaj. Përfaqësuesit e SBASHK-ut e kanë informuar Këshillin e Prindërve të Kosovës për gjendjen aktuale në arsim dhe për kërkesat legjitime të anëtarësisë, duke shprehur shqetësimin për qasjen e gabuar të Qeverisë ndaj sindikatave dhe ndaj dialogut, i cili me fajin e Qeverisë po mungon dhe kjo ka krijuar pakënaqësi te anëtarësia dhe janë shtuar zërat për veprime sindikale. Këshilli i Prindërve është njoftuar edhe me kërkesat e anëtarësisë së SBASHK-ut dhe për angazhimet që të gjenden mundësi për dialog e zgjidhje të kërkesave me qëllim që të mos ketë nevojë për veprime sindikale. Përfaqësuesit e Këshillit të Prindërve të Kosovës janë shprehur se kuptojnë shqetësimet e SBASHK-ut, por

kanë kërkuar që të shtohen angazhimet për dialog me qëllim që kërkesat legjitime të punëtorëve të arsimit të gjejnë zgjidhje të drejtë që të mos ketë nevojë për veprime sindikale. Përfaqësuesit e SBASHK-ut janë shprehur të gatshëm të vazhdojnë me përkushtim për takime e për dialog të mirëfilltë me institucionet, por nuk kanë përjashtuar veprimet sindikale nga mesi i shtatorit e tutje nëse vazhdon të mungojë dialogu dhe angazhimi i Qeverisë për realizimin e kërkesave të anëtarësisë.



Përfaqësues të SBASHK-ut u pritën nga kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së



Përfaqësues të SBASHK-ut sot qëndruan në Kuvendin e Kosovës ku u pritën nga kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, z. Arben Gashi, i shoqëruar nga deputetët z. Avdullah Hoti dhe znj. Hykmete Bajrami. Në këtë takim u diskutuan çështje të ndryshme në fushën e arsimit, me theks të veçantë fillimi i vitit të ri shkollor. Kryetari i SBASHK-ut, z. Rrahman Jasharaj, i njoftoi deputetët se viti i ri shkollor do të fillojë siç është paraparë me kalendarin shkollor, pa vonesa, mirëpo theksoi se shqetësuese mbetet mungesa e gatishmërisë së MASHTI-t për dialog me qëllim të realizimit të kërkesave legjitime të anëtarësisë e në veçanti njoftimi për shkëputje të njëanshme të kontratës kolektive nga ministrja Nagavci.

Kryetari Jasharaj theksoi se është në përfundim të

përgatitjes drafti i Kontratës Kolektive i cili së shpejti do të diskutohet me anëtarësinë dhe ai do t'i dërgohet MASHTI-t duke shpresuar se do të ketë reflektim pozitiv dhe se komisionet do të punojnë për të arritur të teksti final i Kontratës Kolektive të Arsimit.

Jasharaj ka shprehur shqetësim edhe lidhur me ndryshimet që janë bërë në Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti ngase janë dëmtuar punëtorët e arsimit sepse u është mohuar e drejta e fituar me heqjen padrejtësisht të pikës 6 të nenit 8, që garantonte se vitet e 90-ta numëroheshin si vite kontributdhënëse për punëtorët e arsimit që në vitet 90-ta kanë mbrojtur shkollën shqipe duke punuar me sistemin arsimor të Republikës së Kosovës.

Z. Jasharaj ka përmendur edhe kërkesat tjera të anëtarësisë duke u ndalur edhe te ajo që urgjentisht të ngritet vlera e koeficientit të pagave për së paku 30%. Përfaqësuesit e Grupit Parlamentar të LDK-së janë shprehur se përkrahin kërkesat legjitime të punëtorëve të arsimit dhe se do të vazhdojnë me angazhimet në kuadër të Parlamentit të Kosovës që çështjet të gjejnë zgjidhje përmes debatit parlamentar dhe përmes dialogut në mes të Qeverisë dhe SBASHK-ut.

Përfaqësuesit e SBASHK-ut me qëllim që të krijohen mundësi për realizimin e kërkesave përmes dialogut, do të vazhdojnë angazhimet për takime edhe me përfaqësues të tjerë të popullit, por edhe me Këshillin e Prindërve dhe me palët tjera të vullnetit të mirë.

Gabim i përsëritur i MASHTI-t për tekstet shkollore



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës

SBASHK-u, por edhe të tjerët, kishin kritikuar arsyeshëm vendimin e vitit të kaluar lidhur me shpërndarjen e teksteve shkollore përmes librarive dhe subvencionimin për to në xhirollogaritë e prindërve. Ky vendim i gabuar

krijoi probleme dhe shtatori e tetori i vitit të kaluar shkollor i gjeti një numër të konsideruar të nxënësve ende pa të gjitha tekstet shkollore. SBASHK-u këtë kundërshtim e ka përsëritur edhe në takimin e kryetarit Jasharaj me zëvendësministrin Taulant Kelmendi, duke e lutur që mos të veprohet njëjtë me tekstet shkollore, por që ato të dërgohen me kohë në shkolla nga botuesit. U pa se MASHTI nuk ka dëgjuar kritikën e arsyeshme, e as këshillat tona, të Këshillit të prindërve, e as të palëve tjera dhe do ta përsëris gabimin. Konsiderojmë se Këshilli i prindërve duhet ta thotë fjalën e vet lidhur

me këtë veprim të gabuar e të përsëritur të MASHTI-t, sepse ata janë zëri i prindërve të Kosovës, ndërsa ne do të vazhdojmë të jemi zë i anëtarësisë sonë në kërkim të dialogut dhe realizimit të kërkesave.

Zonja Nagavci duhet të merret me këto kërkesa, që në mënyrë të shkruar prapë ia kemi ripërsëritur dhe ia

kemi dorëzuar zëvendësministrit Kelmendi në takimin me ftesën e tij. Për këshillat e saj se çfarë duhet të bëjë SBASHK nuk kemi nevojë, se ne veprojmë bazuar në zërin dhe kërkesat e anëtarësisë. Të gjithë duhet ta arsyetojmë e respektojmë besimin e atyre që përfaqësojmë.

Respekt i veçantë për SBASHK-un në Kongresin Botëror të EI-së në Buenos Aires të Argjentinës

Kongresi i 10 Botërorë i Internacionales të Arsimit i cili u mbajt nga data 25 korrik deri më 2 gusht 2024 në Buenos Aires të Argjentinës, ka përmbyllur me sukses punimet duke debatuar shtruar për problemet e shumta të arsimit në të gjitha vendet e botës, e duke aprovuar një varg Rezolutash si alarm ndaj qeverive që të respektojnë demokracinë dhe të zhvillojnë dialog të sinqertë në mbrojtje të figurës së mësuesit kudo në botë.

Gjatë ditëve të Kongresit, përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë ndjerë respektin e lartë që ka EI dhe shumë nga sindikatat e botës për Sindikatën e Arsimit të Kosovës. Kjo është thënë në takimet e zhvilluara me kryetarin e ri të EI-së z. Mugvena Maluluke, me nënkryetaren znj. Johanna Jaara Astrad, por edhe me sekretarin e përgjithshëm të Internacionales Botërore të Arsimit, z. David Edvards, i cili mori besimin edhe për një mandat në këtë detyrë tepër të rëndësishme në EI.

Takime patën edhe me Kryetaren e deritashme të EI-së, znj. Susan Hopgood dhe nënkryetaren e EI, znj. Lily Eskelsen Garcia nga NEA e SHBA-së. Nënkryetarja e SBASHK-ut, znj. Vjollca Shala dhe koordinatori për organizim të brendshëm, z. Ymer Ymeri, në takimet miqësore me këta përfaqësues të lartë të sindikatave të botës, u kanë përcjellë atyre përshëndetjet dhe falënderimet e kryetarit Jasharaj dhe gjithë anëtarësisë, duke i njoftuar për gjithë agazhimet e sindikatës në shërbim të anëtarësisë, për sfidat, por edhe për arritjet e shumta. Përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë marrë përgëzime për këto angazhime dhe u është thënë se gëzojnë përkrahje të plotë nga Internacionalja Botërore e Arsimit në rrugëtimin e vështirë, por shumë të suksesshëm si zë i fuqishëm sindikal.

Një takim të veçantë përfaqësuesit e SBASHK-ut e kanë zhvilluar edhe me kryetarin e Unionit të Sindikatave të Arsimit të Evropës, z. Larry Flanagan, i cili ka përgëzuar SBASHK-un për gjithë angazhimet dhe ka përsëritur përkrahjen e fuqishme të ETUCE për sindikatën e arsimit të Kosovës. Takime në atmosferë vëllazërore përfaqësuesit e SBASHK-ut kanë zhvilluar edhe me përfaqësues të lartë të sindikatave të punëtorëve të arsimit të SHBA, Randi Veingarten, Daniel Montgomery, Lily Eskelse e Princess R.Moss.

Nga takimet e rëndësishme të përfaqësuesve të SBASHK-ut në kuadër të Kongresit të 10 të Internacionales Botërore të Arsimit, do veçuar edhe atë me znj. Finnern Maikë – anëtare e Bordit të EI-së nga Evropa dhe Kryetare e GEW të Gjermanisë, znj. Trudy Kerperien – nënkryetare e ETUCE nga sindikata Aob Holandë, znj. Marjana Kolar – Kryetare e Sindikatës së Arsimit të Sllovenisë dhe me sindikalistët e Arsimit të Izraelit. Në këto takime është bashkëbiseduar për situatën aktuale të arsimit në këto shtete dhe për forcimin e bashkëpunimit mes këtyre sindikatave.

